



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

K.DH.SH.II.nr.194/23

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS** -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Franciska Zhitija Ymeri kryetare e kolegjit, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Faton Bajrami, anëtare të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Game Plus” Sh.p.k me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Bajram Morina, avokat nga Gjakova, kundër të paditurës Njësia për Inteligjencë Financiare, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Avokatura Shtetërore, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale –Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.97/22, të datës 14.11.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 05.04.2024, merr këtë:

**A K T G J Y K I M**

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditësit “Game Plus” Sh.p.k me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Komerciale –Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.97/22, të datës 14.11.2022, vërtetohet.

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e Gjykatës Komerciale –Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.97/22, të datës 14.11.2022, është refuzuar në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit “Game Plus” Sh.p.k, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit FIUAD 51/2019 të datës 13.03.2019 i nxjerrë nga i padituri Njësia për Inteligjencë financiare.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë paditësi, për shkak të: shkeljes së dispozitave të procedurës LPK, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale në dëm të paditësit. Me propozim që të aprovohet në tërësi si e bazuar ankesa e paditësit NTSH “Game Plus” Sh.p.k me seli në Prishtinë, kurse aktvendimi Gjykatës Komerciale në Prishtinë-Dhoma e Shkallës së Parë, Divizionit Fiskal, KF.nr.97/22 i datës 14.11.2022, priset dhe ndryshohet në dobi të paditësit, ashtu që me këtë aktgjykim, të aprovohet si e bazuar në tërësi padia dhe kërkesëpafia e paditësit NTSH “Game Plus” Sh.p.k me seli në Prishtinë, priset dhe ndryshohet në dobi të paditësit vendimi i Komisionit për Ankesa të Njësisë për Inteligjencë Financiare e Kosovës nr. FIUAD: 51/2019 i datës 14.03.2019 dhe paditësi NTSH “Game Plus” Sh.p.k me seli në Prishtinë, të lirohet nga detyrimi për të paguar ndëshkimin-gjobën administrative në shumë të përgjithshme prej 25,000.00€.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të LKA, nenit 81.H të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me vendimin e kundërshtuar nr.51/2019 i datës 13.03.2019, të Njësisë për Inteligjencë Financiare-Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave, nën pikën I të dispozitivit të vendimit është refuzuar si e pa bazuar ankesa me numër protokoll FIUAD: 42/2019 e datës 15.02.2019 e subjektit raportues “Game Plus” Sh.p.k (tutje ankuesi) me NRF. 600372932 dhe NRB: 70449344 dhe konfirmohet validiteti i vendimit të Njësisë për Inteligjencë Financiare me nr. protokoll FIUAD: 21/2019 i datës 25.01.2019. Nën pikën II. Obligohet subjekti raportues “Game Plus” Sh.p.k që në afat brenda 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi të bëjë pagesën e gjobës, sipas udhëzimeve të pranuar me vendimin me nr. protokoll FIUAD: 21/2019 i datës 25.01.2019 nën pikën III. të dispozitivit, ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Paditësi i pa kënaqur me ndëshkimin nga e paditura Njësia e Inteligjencës Financiare-Komisioni për shqyrtimin e Ankesave, për shkak të mos zbatimit të Ligjit nr.05/L-096, ka ushtruar padi për

konflikt administrativ me datën 11.04.2019 me pretendim se i njëjti është i pa drejtë dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore.

Dhoma e Shkallës së Parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit paraqitur kundër vendimit nr.51/2019 i datës 13.03.2019, të Njesisë për Inteligjencë Financiare në Prishtinë, dhe pas administrimit të provave si në procesverbalin e shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin e refuzon kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar. Me arsyetim se gjykata vlerëson se nga provat e administruara ka rezultuar se i padituri ka vepruar drejtë kur paditësit i ka shqiptuar gjobë në shumë prej 25,000.00€ për shkak të shkeljes së dispozitave të Ligjit nr. 05/L-096 e të cilat janë të sanksionuara me nenin 43 par.1 , nën par. 1.1, 1.2, 1.7, 1.9, 1.13, 1.16 dhe 1.18 të këtij Ligji. Për të vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të goditur, gjykata iu referua nenit 16 par.1, nën par 1.3 të Ligjit nr. 05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit. Në kuptim të këtyre dispozitave ligjore, gjykata vlerësoi pretendimet e përfaqësuesit të paditësit se Administrata Tatimore e Kosovës është autoriteti i vetëm mbikëqyrës i lojërave të fatit dhe se i padituri nuk ka pasur ndonjë autoritet mbikëqyrje në këtë rast, por gjykata vlerëson se nga neni 16 par.1, nën par. 1.3 i Ligjit 05/L-096, paditësi kualifikohet si subjekt raportues ndërsa në nenet 17, 18, 19, 20, 21 dhe 22 të këtij ligji janë përcaktuar detyrimet e subjekteve raportuese e që në këtë rast përfshihet nga paditësi. Gjukata vlerësoi faktin se paditësi ka dorëzuar si provë rregullore për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit dhe faktin se e njëjta është nxjerrë pas realizimit të vizitës inspektuese, por gjykata vlerëson se në asnjë rrethanë e tillë nuk kishte ndikim në vendosjen ndryshe me përmbushjen e detyrimeve ligjore të paditësit deri në kohën e realizimit të inspektimit nga ana e të paditurit, kjo pasi që detyrimi ka rrjedh nga momenti i hyrjes në fuqi të ligjit. Gjukata po ashtu konstatoi se në nenin 18 të Ligjit nr. 05/L-096 është përcaktuar obligimi i subjekteve raportuese që të bëjnë vlerësimin e parandalimit të rrezikut ndërsa nga prova procesverbal i inspektimit të paluajhtëshmërisë, gjykata vlerëson se paditësi nuk e ka përmbushur këtë obligim, andaj gjoba e shqiptuar nga i padituri duke u mbështetur në nenin 42 par.1 nën par. 1.9 të Ligjit nr. 05/L-096 është e drejtë. Gjukata i gjeti si të bazuara edhe konstatimet e të paditurit lidhur me shkeljet nga neni 19 i Ligjit nr. 05/L-096 pasi që sipas kësaj dispozite paditësi ka pasur obligim që të bëjë identifikimin e klientit dhe verifikimin e identitetit të klientit, me anë të burimeve të pavarura, dokumenteve, të dhënave dhe informacioneve të besueshme, ndërsa në procedurë administrative është vërtetuar se i njëjti nuk bënë identifikimin dhe verifikimin e klientëve. Gjukata ka vlerësuar edhe nenin 21 par.1 të Ligjit 05/L-096 e cila dispozitë obligon subjektet raportuese të emërojnë zyrtarin e

paluajtshmërisë, ndërsa nga provat e administruara, gjykata ka konstatuar se paditësi ka emëruar zyrtarin e paluajtshmërisë vetëm pas realizimit të inspektimit të paluajtshmërisë, përkatësisht me datë 26.10.2018 andaj nga provat e administruara, gjykata vlerëson se vendimi kontestues me të cilin është refuzuar ankesa e paditësit kundër vendimit me të cilin i është shqiptuar gjoja administrative në shumë prej 25,000.00€ është i drejtë pasi që i padituri në procedurë administrative drejtë ka vlerësuar shkelje të paditësit lidhur me mos zbatimin e Ligjit nr. 05/L-096. Gjkata vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit bazuar në nenin 13 par.1, nën par. 1.12 lidhur me par.5 të Ligjit nr.08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje Dhoma e Shkallës së Dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjkata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të kontestuar në kuptim të nenit 41 dhe 44 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë ka konstatuar se kërkesëpadija e paditësit është e pa bazuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore se Dhoma e Shkallës së parë ka vërtetuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë gjendjen faktike në dëm të paditësit, me çka ka cenuar rëndë dispozitat e nenit 183 të LPK-së, aktgjykimit të ankimuar i mungojnë arsyet ligjore dhe faktet vendimtare për nxjerrjen e aktgjykimit të ankimuar me ankesë, me çka Dhoma e Shkallës së Parë konsiderohet se ka bërë shkelje të rënda të dispozitave nga neni 182.1 dhe 182.2 pika i) dhe n) të LPK-së dhe se ka aplikuar gabimisht të drejtën materiale në dëme të paditësit- kundër paditurit, me çka ka cenuar rëndë dispozitat e nenit 184 të LPK-së, këto pretendime nuk qëndrojnë, pasi që aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave procedurale, meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë, nuk ka bërë shkelje të dispozitave procedurale të LKA-së dhe LPK-së.

Ndërsa sa i përket i përket pretendimeve ankimore Dhoma e Shkallës së Parë nuk ka marrë parasysh pretendimet dhe provat materiale të paditësit në çështjen juridike kontestuese në mes palëve ndërgjyqëse, respektivisht nuk janë vërtetuar dhe nuk janë qartësuar nga gjykata, andaj nga ky lëshim i gjykatës ka ardhur deri tek vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike dhe gjer tek aplikimi i gabuar i së drejtës materiale në dëm të paditësit. Kolegji i kësaj gjykate këto pretendime ankimore nuk i aprovoi, për faktin se Dhoma e Shkallës së Parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e tij janë të pa bazuara, ngase të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e organit të paditur dhe në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës. Kjo për faktin se nga administrimi i provave materiale, Dhoma e Shkallës së Parë me të drejtë ka konstatuar se i padituri në prezencë të personit të autorizuar të paditurit z. B.V. ka kryer inspektimin në njësinë e paditësit në rr. Bill Clinton dhe ndër të tjera kanë konstatuar se nuk është caktuar zyrtari për paluajtëshmeri, nuk bëhet identifikimi i klientëve në hyrje, në rast se fitojnë apo në rast se janë persona të ekspozuar politikisht. Po ashtu është konstatuar se deri në ditën e inspektimit nuk është raportuar në NJIF, nuk kanë listë të indikatorëve dhe nuk posedojnë rregullore të brendshme për vlerësimin dhe parandalimin e rrezikut. Gjykata po ashtu ka konstatuar se ky procesverbal është nënshkruar nga zyrtarët e NJIF dhe përfaqësuesi i paditësit. Po ashtu, gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se i padituri së bashku me vendimin FIUAD 21/2019 të datës 25.01.2019 paditësit i ka lëshuar edhe faturën për pagesën e gjobës administrative. Dhoma e Shkallës së Parë ka vlerësuar se nga provat e administruara ka rezultuar se i padituri ka vepruar drejtë kur paditësit i ka shqiptuar gjobë në shumë prej 25,000.00€ për shkak të shkeljes së dispozitave të Ligjit nr. 05/L-096 e të cilat janë të sanksionuara me nenin 43 par.1, nën par. 1.1, 1.2, 1.7, 1.9, 1.13, 1.16 dhe 1.18 të këtij Ligji. Prandaj, Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se edhe e drejta materiale është aplikuar drejtë, dhe se nuk është shkelur ligji në dëm të paditësit.

Duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes Dhoma e Shkallës së Dytë gjen se ashtu siç është vepruar edhe nga Dhoma e Shkallës së parë pretendimet e paditësit janë të pa bazuara sa i përket pretendimit se gjoba administrative në shumë prej 25,000.00€ konsiderohet se nuk është në përputhje me ligjin në Kosovë dhe se paraqet tejkallim të autorizimeve dhe kompetencave të paditurës, bazuar në ligjin në fuqi që rregullon çështjen e afarizmit të bizneseve të lojërave të fatit, dhe Ligjin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, pasi që gjobat e shqiptuara nga ana e të paditurës NJIF janë të përcaktuara në kuadër të diskrecionit që i ka përcaktuar ligji, duke mos tejkalluar kufijtë e përcaktuar me ligj dhe se një gjobë e tillë ka pasur për qëllim ti shërbej në mënyrë sa më të përshtatshme interesit publik, ndërsa lidhur me obligimet ligjore që paditësi

ka pasur, në momentin e licencimit por edhe përmes e-mailit të datës 24.04.2014 i njëjti është njoftuar përkatësisht ftuar që të marr pjesë në trajnim lidhur me obligimet që dalin nga ky ligj. Prandaj, nga kjo gjendje rezulton se Dhoma e Shkallës së Parë drejtë ka vendosur kur është bazuar në dispozitat e nenit 52 paragrafi 1 të Ligjit nr. 05/L-096, si dhe në kuptim të nenit 13 paragrafi 1 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Kolegji i kësaj gjykate vlerësoj edhe pretendimet ankimore lidhur me atë se gjoba e shqiptuar është në kundërshtim me nenin 49 paragrafi 2 i ligjit 05/L-096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit nuk qëndron për shkak se kjo dispozitë ligjore nuk parasheh afatshmëri sa i përket obligimit të paditësit për ta raportuar në NJIF-K, andaj, sipas vlerësimit të Dhomës së Shkallës së Dytë, aktgjykimi i kontestuar është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, duke vlerësuar se edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë**

K.DH.SH.II.nr.194/23, me datë 05.04.2024

**Kryetare e kolegjit,**  
Franciska Zhitija Ymeri